

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

PROGRAMI

I KURSIT TË UNIFIKUAR

**“UDHËRRËFIM
TURISTIK”**

Kodi: PK-G-5-22

Miratoi:

MINISTRI

.....

Tiranë, 2022

PROGRAMI I KURSIT

“UDHËRRËFIM TURISTIK”

(PK-G-5-22)

I. Profili Profesional i udhërrëfyesit turistik

a) Karakteristikat e udhërrëfyesit turistik

Udhërrëfyeshi turistik do të jetë i aftë të kryejë detyra profesionale si i punësuar apo i vetpunësuar për të ofruar shërbimet që kanë të bëjnë me udhëheqjen e individëve ose grupeve të turistëve gjatë eskursioneve ose udhëtimeve disa ditore.

Për realizimin me sukses të këtyre detyrave, udhërrëfyeshi turistik duhet që të zotërojë njohuri mbi mjedisin natyror dhe trashëgiminë, mbi teknikat e guidimit, si dhe aftësitë praktike për të interpretuar dhe zbatuar ato.

Suksesi i udhërrëfyesit turistik është i lidhur ngushtë dhe me aftësitë personale për të menaxhuar grupin, përballuar situata të ndryshme dhe rrespektuar kodin e sjelljes dhe etikës në turizëm.

b) Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale e udhërrëfyesit turistik

Pas përfundimit me sukses të këtij kursi trajnimi kursanti do të ketë fituar njohuritë dhe shprehjet e duhura profesionale për të ushtruar detyra si i punësuar pranë agjencive dhe operatorëve turistikë në rolin e udhërrëfyesit turistik ose edhe si profesionist i lirë.

Përfundimi i këtij kursi do t'i mundësojë kursantit themelimin dhe vetëpunësimin e tij pranë një biznesi individual të tij në fushën e udhërrëfimit.

Me përvojë pune dhe me kualifikime shtesë mund të përparojë profesionalisht në nivelin e specialistit të kualifikuar të agjencisë dhe operatorëve turistikë. Më pas, nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale apo trajnimit nëpërmjet punës, një udhërrëfyeshi turistik mund të ndërmarrë disa funksione mbikëqyrëse duke ngritur shkallët e karrierës si specialist në fushën e guidimit dhe administrimit të një agjencie apo operatori turistik. Ndjekja e shkollës së lartë, çon në diplomimin e specialistëve të këtij profesioni në nivelin drejtues.

Ky kurs i përgatit kursantët me kompetenca profesionale për të ushtruar veprimtari profesionale të përfshira në njësinë “Nëpunës i guidave turistike”, me kod 3335.03 referuar Listës Kombëtare të Profesioneve.

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit “Udhërrëfim turistik”.

Në përfundin të Kursit për udhërrëfim turistik, kursantët do të jenë të aftë të:

- Të përshkruajnë tregun turistik, strukturën e tij, segmentet e tregut;
- Të përshkruajnë legjislacionin në fuqi për udhërrëfimin turistik dhe për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve;
- Të përshkruajnë veçoritë, të drejtat dhe detyrat e udhërrëfyesit turistik;
- Të parapërgatiten për udhëtimin;
- Të mbajnë marrëdhënie me furnitorët e shërbimeve;
- Të përdorin hartat dhe burime të tjera informacioni;
- Të përshtasin udhëtimin me karakteristikat, dinamikën e grupit;
- Të përshtasin udhëtimin me kushtet klimatike dhe të terrenit;
- Të zbatojnë protokollet e sigurisë dhe protokollet lokale të ndihmës së shpejtë;

- Të zbatojnë kodin e sjelljes dhe etikës në turizëm;
- Të informojnë dhe këshillojnë klientët;
- Të presin dhe përcjellin klientët;
- Të menaxhojnë udhëtimin dhe grupin;
- Të trajtojnë kërkesat e veçanta të klientëve dhe ankesat e tyre;
- Të interpretojnë mjedisin fizik dhe natyrën e destinacionit turistik;
- Të përshkruajnë elementët e gjeografisë humane dhe zhvillimit shoqëror e urban;
- Të përshkruajnë zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyrës;
- Të përshkruajnë Parahistorinë, qytetërimin Ilir dhe Shqipërinë Mesjetare;
- Të përshkruajnë trashëgiminë e destinacionit turistik;
- Të prezantojnë informacion për periudhat e ndryshme kohore të historisë së Shqipërisë;
- Të përshkruajnë trashëgiminë kulturore materiale dhe shpirtërore në destinacionin turistik;
- Të interpretojnë sitet më të rëndësishme arkeologjike në vendin tonë;
- Të përshkruajnë historinë e artit pamor në vendin tonë;
- Të vlerësojë dhe shmangin rreziqet përpara realizimit të udhëtimit;
- Të vlerësojnë dhe shmangin rreziqet gjatë realizimit të udhëtimit;
- Të japin asistencën e duhur në raste emergjente gjatë udhëtimit;
- Të përdorin terminologjinë e duhur në turizëm;
- Të ofrojnë asistencë, informacion dhe interpretime të trashëgimisë kulturore, historike e bashkëkohore për një grup të organizuar turistësh me vërtetësi dhe të përditësuar;
- Të rrespektjë të drejtat njerëzore të gjithë pjesëmarrësve dhe aktorëve në një udhëtim
- Të minimizojë ndikimet e dëmshme në biodiversitet, ekosisteme dhe mjedisin natyror
- Të kujdeset për mirëqenien a kafshëve dhe raporton abuzimet me to.
- Të zbatojë marëveshjet lokale dhe ndërkombëtare mbi tregtimin ilegal të veprave të artizanatit dhe kafshëve të egra

III. Kërkesat e pranimit në Kursin “Udhërrëfim turistik”.

Pjesmarrësit në Kursin “Udhërrëfim turistik” duhet të jenë mbi 18 vjeç, të kenë përfunduar arsimin e mesëm.

IV. Kohëzgjatja e Kursit “Udhërrëfim turistik”.

600 orë mësimore, ku

1 orë mësimore = 45 minuta

V. Modulet e Kursit “Udhërrëfim turistik”

	Titulli i Modulit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet e të Nxënit
1	Hyrje në udhërrëfimin turistik	MK-13-317-22	50 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori 10% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursantja/i përshkruan strukturën e tregut të udhëtimeve dhe turizmit, segmentet e tregut dhe format e turizmit. 2. Kursantja/i përshkruan legjislacionin për udhërrëfimin turistik dhe për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve; 3. Kursantja/i përshkruan veçoritë, të drejtat dhe detyrat e udhërrëfyesit turistik.
2	Aftësitë teknike dhe personale të udhërrëfyesit turistik	MK-13-318-22	120 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursantja/i parapërgatitet për udhëtimin. 2. Kursantja/i mban marrëdhënie me furnitorët e shërbimeve. 3. Kursantja/i përdor hartat dhe burime të tjera informacioni. 4. Kursantja/i përshtat udhëtimin me karakteristikat, dinamikën e grupit. 5. Kursantja/i përshtat udhëtimin me kushtet klimatike dhe të terrenit, si dhe me kërkesat e sigurisë. 6. Kursantja/i zbaton kodin e sjelljes dhe të etikës në turizëm.
3	Shërbimi ndaj klientit dhe grupeve turistike	MK-13-319-22	70 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursantja/i informon dhe këshillon klientët. 2. Kursantja/i pret dhe përcjell klientët. 3. Kursantja/i menaxhon udhëtimin dhe grupin. 4. Kursantja/i trajton kërkesat e veçanta të klientëve dhe ankesat e tyre.
4	Interpretimi i burimeve natyrore	MK-13-320-22	100 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursantja/i interpreton mjedisin fizik dhe natyrën e destinacionit turistik. 2. Kursantja/i përshkruan elementët e gjeografisë humane dhe zhvillimit shoqëror e urban. 3. Kursantja/i përshkruan zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyrës.

5	Interpretimi i historisë, trashëgimisë, kulturës, etnografisë dhe arkeologjisë	MK-13-321-22	150 orë mësimore Rekomandohet 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursantja/i shpjegon parahistorinë, qytetërimin ilir dhe Shqipërinë mesjetare. 2. Kursantja/i shpjegon informacionin për periudhat kohore të historisë së Shqipërisë. 3. Kursantja/i përshkruan trashëgiminë e destinacionit turistik. 4. Kursantja/i përshkruan trashëgiminë kulturore materiale dhe shpirtërore në destinacionin turistik. 5. Kursantja/i interpreton sitet më të rëndësishme arkeologjike në vendin tonë. 6. Kursantja/i shpjegon historinë e artit pamor në vendin tonë.
6	Menaxhimi i riskut dhe i sigurisë gjatë udhëtimit turistik	MK-13-322-22	70 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursantja/i vlerëson dhe shmang rreziqet përpara realizimit të udhëtimit turistik. 2. Kursantja/i vlerëson dhe shmang rreziqet gjatë realizimit të udhëtimit turistik. 3. Kursantja/i jep asistencën e duhur në raste emergjente gjatë udhëtimit turistik.
7	Qëndrueshmëria në udhërrëfimin turistik	MK-13-323-22	40 orë mësimore Rekomandohet: 50% Teori 40% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursantja/i respekton të drejtat njerëzore të pjesëmarrësve dhe aktorëve në një udhëtim turistik. 2. Kursantja/i minimizon ndikimet e dëmshme në biodiversitet, ekosisteme dhe mjedisin natyror. 3. Kursantja/i kujdeset për mirëqenien a kafshëve dhe raporton abuzimet me to. 4. Kursantja/i zbaton marrëveshjet lokale dhe ndërkombëtare mbi tregtinë ilegale.

VI. Vlerësimi dhe Çertifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e Kursit për të gjitha Rezultatet e të Nxënit që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në Provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë Çertifikatën përkatëse që njihet nga MFE.

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit “Udhërrëfim turistik”:

1. Moduli “Hyrje në udhërrëfimin turistik”

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	HYRJE NË UDHËRRËFIMIN TURISTIK	MK-13-317-22
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i pajis kursantët me njohuritë dhe aftësitë për t’u orientuar në tregun e udhëtimeve dhe turizmit, për të zbatuar detyrimet, detyrat dhe për të marrë përsipër përgjegjësitë e tij në përputhje me legjislacionin në fuqi.	
Kohëzgjatja e modulit	50 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori, 10% Praktikë, 10% Vlerësime.	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm dhe të jenë mbi 18 vjeç.	
Rezultatet e të Nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	<p>Kursantja/i përshkruan strukturën e tregut të udhëtimeve dhe turizmit, segmentet e tregut dhe format e turizmit.</p> <p>Kriteret e vlerësimit: Kursantja/i duhet të jetë e/i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të dallojë gamën e ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari të lidhura me turizmin në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo; - të përshkruajë objektin e veprimtarisë dhe karakteristikat e ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në fushën e turizmit; - të përshkruajë karakteristikat e strukturave akomoduese dhe rolin e tyre në tregun e udhëtimeve dhe turizmit dhe klasifikojë ato; - të argumentojë domosdoshmërinë e strukturave që ofrojnë shërbime të ushqimit; - të rendisë sektorët ndihmës të tregut të udhëtimeve dhe turizmit: (atraksionet turistike, argëtimet, ngjarjet, veprimtaritë, festivalet, sektorin e suvenireve dhe dyqaneve,etj) - të përshkruajë llojet e transportit, karakteristikat, veçoritë dhe rolin e tyre në funksion të turizmit (transporti ajror, detar, rrugor, hekurudhor, etj). - të përshkruajë rolin dhe vendin e operatorit turistik në treg; - të përshkruajë rolin e agjencive të udhëtimit dhe turizmit dhe të ndërmjetësve të tjerë të tregut; - të përshkruajë rolin në tregun e udhëtimeve dhe turizmit të aktorëve të tjerë si organizatat dhe shoqatat e turizmit, institucionet publike lokale dhe qendrore, ministrisë së turizmit; - të dallojë format e turizmit sipas lëvizjes (hyrës, dalës dhe

-
- turizëm vendas);
- të klasifikojë llojet e turizmit sipas qëllimeve të udhëtimit;
 - të shpjegojë karakteristikat e turizmit të aventurës dhe atij të qendrueshëm;
 - të evidentojë tiparet bazë të turizmit kulturor;
 - të shpjegojë çfarë është turizmi për pushime (leisure);
 - të rendisë karakteristikat dalluese të turizmit MICE (takime, stimuj, konferenca, ekspozita);
 - të dallojë tiparet përcaktuese dhe kushtet që duhet të plotësojë turizmi i luksit;
 - të shpjegojë nocionin e turizmit mjekësor;
 - të përshkruajë karakteristikat dalluese të turizmit për të rinj.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Pyetje përgjigje me shkrim.

RN 2 Kursantja/i përshkruan legjislacionin në fuqi për udhërrëfimin turistik dhe për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursantja/i duhet të jetë e/i aftë:

- të tregojë normativat ligjore në fuqi sipas ligjit “për turizmin” dhe akteve nënligjore të tij;
- të përshkruajë qëllimin e ligjit të turizmit;
- të shpjegojë domosdoshmërinë e rregullimit ligjor të marëdhënieve ndërmjet aktorëve të ndryshëm që veprojnë në tregun e udhëtimeve dhe turizmit;
- të përshkruajë rolin e udhërrëfyesit turistik në tregun e udhëtimeve dhe turizmit;
- të tregojë normativat ligjore që rregullojnë kualifikimin e udhërrëfyesit turistik;
- të rendisë kategoritë e udhërrëfyesve turistikë sipas legjislacionit shqiptar;
- të përshkruajë kriteret e certifikimit të udhërrëfyesve turistikë sipas kategorive të tyre;
- të përshkruajë të dhënat bazë të kontratës me konsumatorin;
- të shpjegojë domosdoshmërinë e respektimit të kërkesave të legjislacionit për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve;
- të përshkruajë disa nga normativat ligjore kryesore për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve sipas legjislacionit shqiptar dhe atij të BE;
- të respektojë të drejtat e konsumatorit në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe atë të BE.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë.
- Pyetje-përgjigje me shkrim.

RN 3 Kursantja/i përshkruan veçoritë, të drejtat dhe detyrat e udhërrëfyesit turistik.

Kriteret e vlerësimit:

Kursantja/i duhet të jetë e/i aftë:

- të përshkruajë detyrimet ligjore të udhërrëfyesit turistik ndaj klientëve dhe operatorëve apo agjencive të udhëtimit;
- të tregojë rolin dhe funksionet që i lejohen të ushtrojë udhërrëfyesit turistik në treg sipas legjislacionit në fuqi;
- të respektojë rolin dhe pozicionin e tij në treg;
- të listojë detyrat e udhërrëfyesit turistik;
- të spjegojë të drejtat e udhërrëfyesit turistik;
- të tregojë normativat ligjore lidhur me numrin e turistëve që duhet të ketë në grup udhërrëfyesi.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë.
- Pyetje-përgjigje me shkrim.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara, materiale pamore dhe të shkruara për përvetësimin sa më mirë të rezultateve mësimore.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete për marrjen e njohurive dhe shprehive të kërkuara në modul. Ata duhet të kryejnë detyra të ndryshme që lidhen me njohjen e industrisë turistike, veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, kuadrit ligjor të turizmit dhe mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive dhe shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Studime të tregut turistik.
 - Ligjet dhe aktet nënligjore për turizmin.
 - Rregullat mbi çertifikimin e licencimin e udhërrëfyesit turistik.
 - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

2. Moduli: “Aftësitë teknike dhe personale të udhërrëfyesit turistik”

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	AFTËSITË TEKNIKE DHE PERSONALE TË UDHËRRËFYESIT TURISTIK	MK-13-318-22
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i pajis kursantët me aftësi për të kryer parapërgatitjet për udhëheqjen e udhëtimit, mbajtur marrëdhëniet me furnitorët e shërbimeve gjatë udhëtimit, përdorur burime të ndryshme informacioni për të përgatitur udhëtimin dhe informuar klientët, përshtatur udhëtimin me dinamikën e turistëve dhe kushtet atmosferike dhe të terrenit, plotësuar nevoja e kërkesa të veçanta të klientëve dhe për të respektuar normat e kodit të sjelljes dhe etikës në biznesin turistik.	
Kohëzgjatja e modulit	120 orë mësimore Rekomandohet:10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm, të jenë mbi 18 vjeç dhe të kenë kryer modulin “Hyrje në udhërrëfimin turistik”.	
Rezultatet e të Nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursantja/i parapërgatitet për udhëtimin. Kriteret e vlerësimit: Kursantja/i duhet të jetë e/i aftë : <ul style="list-style-type: none">- të listojë veprimet që duhet të kryejë një udhërrëfyes efektiv gjatë udhëtimit;- të listojë veprimet që nuk duhet të kryejë një udhërrëfyes efektiv gjatë udhëtimit;- të evidentojë materialet që nevojiten për realizimin e udhëtimit;- të përgatisë materiale që do i nevojiten gjatë udhëtimit;- të hartojë lista të dokumentave që duhet të sigurojë gjatë udhëtimit;- të përgatisë prezantimin i tij me turistët;- të interpretojë itinerarin e udhëtimit;- të parapërgatisë materialet informative për turistët gjatë udhëtimit;- të përgatisë për turistët informacion mbi detaje të itinerarit të udhëtimit turistik, ndalesat, pushimet, vizitat etj;- të përdorë hartën dhe mjete të tjera orientuese për të planifikuar lëvizjet gjatë udhëtimit (gps, app, etj);- të planifikojë kohën për çdo ditë apo aktivitet e udhëtimit;- të planifikojë koordinimin e orareve të lëvizjeve dhe ndalesave;- të interpretojë informacionin në mënyrë të kuptueshme;- të planifikojë teknikat që do të përdorë për përfshirjen e turistëve pjesëmarrës;- të planifikojë teknikat që do të përdorë për nxitjen e vëmendjes së turistëve pjesëmarrës;	

-
- të planifikojë teknikat që do të përdorë për mbajtjen e turistëve entuziastë;
 - të hartojë listëkontrolle që do të përdoren gjatë udhërrëfimit dhe lëvizjeve të grupit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë.
- Pyetje-përgjigje me shkrim.

RN 2 Kursantja/i mban marrëdhënie me furnitorët e shërbimeve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursantja/i duhet të jetë e/i aftë :

- të bashkërendojë punën me hotelet, restaurantet, ofruesit e aktiviteteve të ndryshme sipas programit të udhëtimit;
- të njoftojë në kohë furnitorët e shërbimeve për mbërritjen e grupit;
- të dërgojë listat e azhornuara të pjesëmarrësve tek furnitorët e shërbimeve;
- të bashkërendojë punën me muzeumet dhe atraksionet e ndryshme turistike, duke koordinuar oraret e tyre me itinerarin turistik;
- të kontrollojë cilësinë e shërbimeve të ofruara dhe përputhjen e tyre me kontratat;
- të bashkëveprojë me furnitorët e shërbimeve për të siguruar cilësinë e kërkuar të shërbimeve;
- të parandalojë situata të papëlqyera në marrëdhënie me furnitorët e shërbimeve turistike;
- të mbledhë dhe hartojë dokumentacionin financiar vërtetues të shërbimeve të blera.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë.
- Pyetje-përgjigje me shkrim.

RN 3 Kursantja/i përdor hartat dhe burime të tjera informacioni.

Kriteret e vlerësimit:

Kursantja/i duhet të jetë e/i aftë:

- të lexojë saktë hartat e ndryshme (dixhitale dhe leter) në vartësi të llojit të udhëtimit;
- të lokalizojë saktë pikat kufitare të hyrjes dhe daljes nga Shqipëria dhe territoreve jashtë saj;
- të përdorë hartat turistike të ndryshme;
- të lokalizojë saktë në hartë atraksionet natyrore, parqet kombëtare, vendet me interes të veçantë, etj;
- të lokalizojë me saktësi zonat me vlera kulturore, historike, fetare dhe arkeologjike shqiptare;
- të ndërtojë itinerare grafike, bazuar në kërkesën e klientit;
- të përshkruajë saktë rrugën drejt një destinacioni të kërkuar turistik;
- të përdorë saktë shkallën e hartës për llogaritjen e largësive;
- të specifikojë në hartë kilometrat e duhur nga nisja në destinacion
- të përdorë internetin si burim informacioni për evente, festa,

- koncerte, etj;
- të kërkojë dhe përdorë informacione nga publikime zyrtare idh me atraksionet vlera kulturore, historike, fetare dhe arkeologjil etj;
- të përdorë informacionin e ofruar në materiale të tjera të shkrua njoftime apo reklamime të furnitorëve të shërbimeve;
- të kërkojë dhe përdorë informacion mbi oraret e lëvizjeve mjeteve publike të transportit;
- të kërkojë dhe përdorë informacionin e buletineve zyrtare kushteve të motit, detit, rreshjeve, etj.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë.
- Pyetje-përgjigje me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Kursantja/i përshtat udhëtimin me karakteristikat, dinamikën e grupit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursantja/i duhet të jetë e/i aftë:

- të analizojë profilet e turistëve dhe parapërgatisë përshtatjen e udhëtimit sipas tyre;
- të konsiderojë kërkesa të veçanta paraprake të turistëve lidhur me ushqimin, tipologjinë e akomodimit, kohët e aktiviteteve dhe pushimit dhe përshtasë paraprakisht udhëtimin me to;
- të përshtasë udhëtimin për familjet me fëmijë të vegjël;
- të planifikojë përshtatjen e udhëtimit për klientë me background të veçantë kulturor dhe fetar;
- të përshtasë udhëtimin me protokollat lokale të sigurisë dhe të ndihmës së shpejtë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë.
- Pyetje-përgjigje me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Kursantja/i përshtat udhëtimin me kushtet klimatike dhe të terrenit, si dhe me kërkesat e sigurisë.

Kriteret e vlerësimit:

Kursantja/i duhet të jetë e/i aftë:

- të përshtasë planifikimin dhe ecurinë e aktiviteteve dhe vizitave në vartësi të kushteve të motit;
- të përshtasë teknikën përkatëse të udhërrëfimit në lidhje me ndryshimet e paparashikuara të kushteve metereologjike;
- të ndërpresë udhëtimin në rast se kushtet e motit rrezikojnë jetën e turistëve dhe t'a vazhdojë atë në përmirësimin e kushteve metereologjike;
- të marrë vendime për pezullimin e udhëtimit së bashku me organizatorin e udhëtimit;
- të informohet vazhdimisht mbi gjëndjen politike si dhe me ngjarjet që mund të jenë në zhvillim e sipër dhe të

këshillohet me organizatorin për zhvillimin e mëtejshëm të udhëtimit;

- të informohet në vazhdimësi për ngjarje apo fatkeqësi natyrore (termete, zjare, përmbytje, etj.,).

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë.
- Pyetje-përgjigje me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 6 Kursantja/i zbaton kodin e sjelljes dhe të etikës në turizëm.

Kriteret e vlerësimit:

Kursantja/i duhet të jetë e/i aftë:

- të argumentojë domosdoshmërinë e rrespektimit të kodit të etikës;
- të dëshmojë paraqitjen personale në përputhje me kodin e etikës;
- të përshtasë veshjen me llojin e veprimtarisë gjatë udhërrëfimit;
- të përshtasë paraqitjen e jashtme me identitetin e biznesit që përfaqëson;
- të zbatojë rregullat e disiplinës në punë;
- të silllet në mënyrë të përshtatshme, sipas situatës së krijuar;
- të artikulojë drejt në gjuhë kombëtare dhe të huaj;
- të përdorë në mënyrë të përshtatshme gjuhën e trupit;
- të zbatojë rregullat e sjelljes sociale;
- të respektojë privatësinë e klientëve;
- të dëshmojë përgjegjshmëri në punë;
- të jetë i vëmendshëm dhe dëgjues i mirë;
- të dëshmojë higjienë personale;
- të demostrojë vetëkontroll;
- të jetë jodiskriminues;
- të respektojë besimin fetar të çdo turisti;
- të trajtojë dhe të përpiqet të zgjidhë një situatë konflikti me ndjeshmëri dhe përgjegjshmëri;
- të përshkruajë përfitimet e të pasurit një kod etike;
- të jetë kërkues me veten dhe këmbëngulës në realizimin e objektivave.
- të jetë koherent.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë.
- Pyetje-përgjigje me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara, materiale pamore dhe të shkruara për përvetësimin sa më mirë të rezultateve mësimore.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete për marrjen e njohurive dhe shprehive të kërkuara në modul. Ata

duhet të kryejnë detyra të ndryshme që lidhen me planifikimin e udhëtimit, mbajtur marrëdhëniet me furnitorët e shërbimeve gjatë udhëtimit, përdorur burime të ndryshme informacioni për të përgatitur udhëtimin dhe informuar klientët, përshtatur udhëtimin me dinamikën e turistëve dhe kushtet atmosferike dhe të terrenit, plotësuar nevoja e kërkesa të veçanta të klientëve dhe për të respektuar normat e kodit të sjelljes dhe etikës në biznesin turistik.

- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive dhe shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Kodi i etikës në turizëm.
 - Materiale të shkruara lidhur me sjelljen dhe paraqitjen personale në përputhje me veprimtarinë që do të ushtrojnë.
 - Lista detyrash, planifikime, itinerare turistike sipas shembujve të operatorëve të ndryshën në vend dhe të huaj.
 - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

3. Moduli “Shërbimi ndaj klientit dhe grupeve turistike”

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	SHËRBIMI NDAJ KLIENTIT DHE GRUPEVE TURISTIKE	MK-13-319-22
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i pajis kursantët me aftësi për të asistuar klientët para, gjatë dhe pas udhëtimit, menaxhuar udhëtimin dhe trajtuar kërkesat e veçanta të klientëve.	
Kohëzgjatja e modulit	70 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm, të jenë mbi 18 vjeç dhe të kenë kryer modulin “Hyrje në udhërrëfimin turistik”.	
Rezultatet e të Nxënit (RN), dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursantja/i informon dhe këshillon klientët. Kriteret e vlerësimit: Kursantja/i duhet të jetë e/i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të marrë saktë kërkesën nga klienti;- të specifikojë saktë kërkesën e klientit;- të konsultohet me burime të publikuara, për të dhënë informacion mbi oraret e mjeteve të ndryshme të transportit, sipas destinacioneve;- të informojë saktë klientin mbi cilësinë e shërbimit, tarifat dhe specifikat e hoteleve dhe restoranteve;- të informojë saktë klientin mbi kushtet e motit, turet, aktivitete artistike, festa, festivale, teatro, konferenca, mbi dyqanet dhe suvenirët, etj.;- të këshillojë klientin për paketat turistike, me informacion sa më të plotë;- të këshillojë klientin mbi vendet turistike, bazuar në kërkesat, interesat dhe motivet e udhëtimit të tij;- të identifikojë dokumentet e nevojshme për udhëtim;- të informojë klientin mbi dokumentet e sigurimit shëndetësor;- të udhëzojë klientin mbi dokumentet e nevojshme për udhëtim, në raste të ndryshme (kur udhëton me mjete individuale, kur udhëton në vendet që ka marrëveshje bilaterale, etj.);- të udhëzojë mbi dokumentet e udhëtimit, për klientë të sëmurë, invalidë, fëmijë, fëmijë të pa shoqëruar, kafshë shoqëruese;- të informojë klientin në lidhje me rregullat doganore;- të informojë klientin në lidhje me certifikatat e vaksinimit;- të informojë klientin në lidhje me sigurinë personale (krimet, vendet e pasigurta, etj);- të japë udhëzime për besimtarët, personat VIP, tradita të veçanta të vendeve të huaja, etj;	

-
- të identifikojë kursin ditor të këmbimit të monedhave;
 - të udhëzojë klientin në lidhje me dokumentet e tjera të nevojshme për udhëtim.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje-përgjigje me gojë.
- Pyetje-përgjigje me shkrim.

RN 2 Kursantja/i pret dhe përcjell klientët.

Kriteret e vlerësimit:

Kursantja/i duhet të jetë e/i aftë:

- të identifikojë informacionin mbi mbërritjen e turistëve duke kryer ndryshimet në raste vonesash;
- të konfirmojë me transportuesin për kohën dhe vendin e saktë të pritjes në aeroport, port, tren, stacion autobusi apo vende të tjera;
- të përdorë teknikat identifikuese për të lejuar turistët të dallojnë agjentin pritës;
- të verifikojë listën e plotë të emrave për të regjistruar personat e mbërritur, mungesat dhe komentet;
- të rregullojë dhe monitorojë transportimin e bagazheve në terminal;
- të praktikojë procedurat për tu siguruar që të gjitha bagazhet janë transportuar deri tek mjeti i transportit;
- të praktikojë procedurat në rastet e humbjes së bagazheve;
- të japë informacion dhe këshilla gjatë transportit për në hotel për t'i prezantuar turistët me zonën që do të vizitohet;
- të informojë turistët mbi procedurat e akomodimit për të minimizuar konfuzionin dhe vonesat për t'u akomoduar;
- të koordinojë me receptionin për regjistrimin e grupit sipas marrëveshjes me agjencinë apo kërkesave të çastit;
- të informojë grupin në lidhje me orarin e takimit të ardhshëm. të informojë turistët për orarin e largimit nga hoteli;
- të kordinojë me receptionin procedurat e check-out të turistëve;
- të këshillojë turistët për të verifikuar sendet personale dhe bagazhet;
- të verifikojë detajet e largimit të turistëve, para transferimit nga hoteli;
- të kryejë organizimin e nisjes së turistëve nga hoteli;
- të këshillojë turistët për procedura të tjera në aeroport, kërkesat për blerjet pa taksa (duty free), etj;
- të praktikojë procedurat e rregullta të "check-in" në терминаlet e transportit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje-përgjigje me gojë.
- Pyetje-përgjigje me shkrim.

RN 3 Kursantja/i menaxhon udhëtimin dhe grupin.

Kriteret e vlerësimit:

Kursantja/i duhet të jetë e/i aftë:

- të mirëpresë pozitivisht turistët;
- të akomodojë turistët në mjetin e transportit sipas rregullave;
- të komunikojë me turistët gjatë udhëtimit turistik, duke i'u përgjigjur në kohë pyetjeve, kërkesave dhe nevojave të tyre;
- të këshillojë turistët mbi specifikat e udhëtimit si: karakteristikat gjuhësore, kulturore, fetare, mjedisore të vendit që do të vizitohet;
- të kujdeset për sigurinë e grupit gjatë lëvizjes me mjet dhe kohës së ndalesave;
- të përdorë alternativat për zgjidhje dhe përshtatje në situata të caktuara;
- të tregojë interes për idetë, këndvështrimet dhe parimet e pjesëmarrësve në udhëtim në mënyrë tolerante;
- të marrë parasysh, gjatë kryerjes së udhëtimit, gjendjen dhe nivelin e pjesëmarrësve;
- të vlerësojë dhe përshtatë gjendjen dhe nivelin e pjesëmarrësve sipas itinerarit, brenda mundësive të lejuara nga programi me gjendjen e pjesëmarrësve;
- të identifikojë ankesat dhe trajtojë konfliktet duke i zgjidhur, ndërmjetësuar ose bere kompromise, siguruar kujdesin e nevojshëm, duke krijuar mundësinë për të marrë feed back në kohë;
- të trajtojë situatën në raste sëmundjesh, aksidentesh ose fatkeqësish të tjera;
- të gjejë zgjidhje në përputhje me procedurat e përgjithshme, rregullat e sigurisë dhe instruksionet e kompanisë;
- të monitorojë shëndetin dhe mirëqenien e turistëve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë.
- Pyetje-përgjigje me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Kursantja/i trajton kërkesat e veçanta të klientëve dhe ankesat e tyre.

Kriteret e vlerësimit:

Kursantja/i duhet të jetë e/i aftë:

- të identifikojë klientët me aftësi dhe nevoja të veçanta si: nevoja për karrige me rrota, aftësi të kufizuara shqisore, probleme me lëvizshmërinë, njerëzit me fëmijë të vegjël, etj.;

- të identifikojë klientët me nevoja të veçanta si: gjuha e folur, kodet fetare, traditat kulturore, ushqimet, pijet, etj;
- të përgatitë një listë të objekteve dhe nevojave specifike të parashikuara për klientët me aftësi dhe nevoja të veçanta;
- të prezantojë shërbime turistike klientëve me aftësi dhe nevoja të veçanta;
- të pranojë vërejtjet dhe sugjerimet nga klientët për përmirësime të shërbimeve turistike, duke i'u përgjigjur pozitivisht dhe me ndjeshmëri kërkesave të tyre;
- të përgatitë shërbimet përfundimtare turistike duke pasqyruar sugjerimet e klientëve;
- të ofrojë shërbimet turistike klientëve me aftësi dhe nevoja të veçanta.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë.
- Pyetje-përgjigje me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara, materiale pamore dhe të shkruara për përvetësimin sa më mirë të rezultateve mësimore.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete për marrjen e njohurive dhe shprehive të kërkuara në modul. Ata duhet të kryejnë detyra të ndryshme që lidhen me informimin dhe këshillimin e klientëve para udhëtimit, pritjen dhe përcjelljen e turistëve, menaxhimin e grupit gjatë udhëtimit he trajtimin e kërkesave të veçanta të klientëve.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive dhe shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

4. Moduli “Interpretimi i burimeve natyrore

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	INTERPRETIMI I BURIMEVE NATYRORE	MK-13-320-22
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis kursantët me njohuri dhe shprehje për të interpretuar mjedisin fizik, natyrën e destinacionit si dhe karakteristikat e rajoneve të Shqipërisë gjatë ushtrimit të profesionit të udhërrëfyesit, në funksion të zhvillimit të turizmit.	
Kohëzgjatja e modulit	100 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori, 80% Praktikë, 10% Vlerësime.	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm, të jenë mbi 18 vjeç dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në udhërrëfimin turistik”.	
Rezultatet e të Nxënës (RN), dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Kursantja/i interpreton mjedisin fizik dhe natyrën e destinacionit turistik. Kriteret e vlerësimit: Kursantja/i duhet të jetë e/i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të ndërtojë skemën e potencialit turistik të një rajoni duke dalluar potencialin natyror si bazën e ofertës primare turistike;- të vlerësojë elementët natyrorë si bazë e potencialit turistik primar;- të analizojë ndikimin e secilit prej këtyre elementëve në zhvillimin e një rajoni turistik;- të përshkruajë pozitën gjeologjike të truallit shqiptar;- të evidentojë rolin që ka relievi me format e tij të larmishme dhe zhvillimin e turizmit;- të shpjegojë vecoritë e zonave klimatike si komponentë të rëndësishëm në zhvillimin turistik të një hapësire të caktuar gjeografike;- të analizojë rëndësinë e ujit në zhvillimin e turizmit;- të dallojë si plotësohet oferta turistike me praninë e florës dhe faunës;- të vlerësojë dhe argumentojë rëndësinë e trajtimit rajonal të territorit (hapësirës);- të identifikojë kriteret bazë të rajonizimit gjeografik dhe tipet e ndryshëm të rajoneve;- të shpjegojë kuptimin e sotëm evropian mbi rajonin nën frymën e respektimit të diversitetit dhe ndërveprimit rajonal;- të sjellë shembuj të rritjes së ndërvarësisë rajonale përmes proceseve ekonomike, politike, mjedisore e shkëmbimeve kulturore në Evropë. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">- Pyetje përgjigje me gojë.- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Kursantja/i përshkruan elementët e gjeografisë humane dhe zhvillimit shoqëror e urban.

Kriteret e vlerësimit:

Kursantja/i duhet të jetë e/i aftë :

- të japë një vështrim të përgjithshëm mbi elementët e zhvillimit shoqëror dhe urban në vendin tonë;
- të shpjegojë ndërvarësinë midis njerëzve, rajoneve dhe mjedisit në vendin tonë;
- të përshkruajë ecurinë e popullimit përgjatë periudhave të ndryshme në vendin tonë;
- të shpjegojë faktorët kryesorë të urbanizimit të vendit tonë;
- të shpjegojë faktorët që kanë ndikuar në shpërndarjen gjeografike të popullsisë në vendin tonë;
- të shpjegojë tiparet kryesore të kulturës, popullsisë dhe ekonomisë së rajoneve në Shqipëri;
- të përshkruajë strukturat kryesore të popullsisë, si tipar i rëndësishëm për turizmin;
- të përshkruajë efektet e urbanizimit në zhvillimin e turizmit;
- të shpjegojë rëndësinë e infrastrukturës urbane në zhvillimin e turizmit;
- të shpjegojë zhvillimin urban në periudha të ndryshme historike si psh.: qytetit të Durrësit, Butrintit, Beratit, Gjirokastrës etj.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Kursantja/i përshkruan zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyrës.

Kriteret e vlerësimit:

Kursantja/i duhet të jetë e/i aftë :

- të njohë ligjin shqiptar mbi zonat e mbrojtura;
- të listojë kategoritë e zonave të mbrojtura në vendin tonë;
- të përshkruajë karakteristikat e zonave të mbrojtura të kategorisë I-rë si: Lumi i Gashit dhe Rezervati natyror “Kardhiq”;
- të përshkruajë karakteristikat e parqeve kombëtare si: Parku Kombëtar i Lurës, Llogarasë, Valbonës etj.;
- të listojë dhe të shpjegojë monumentet natyrore sipas rajoneve në Shqipëri;
- të përshkruajë karakteristikat e zonave “Rezervat natyror i menaxhuar/park natyror` si: Karaburun, Cangonj etj.;
- të përshkruajë karakteristikat e territoreve `Peisazh i mbrojtur` si: Pogradec, Vjosë-Nartë, Bunë-Velipojë etj.;
- të përshkruajë karakteristikat e territoreve `Zonë e mbrojtur e burimeve të menaxhuara` si: Piskai-Shqeri, Bjeshka e Oroshit etj.;
- të përshkruajë monumentet e trashëgimisë natyrore që janë pjesë e listës së UNESCO-s;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në hapësirë turistike.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në klasë mësimore dhe në terren. Atyre duhet ti jepen detyra të interpretojnë mjedisin fizik, natyrën e destinacionit si dhe karakteristikat e rajoneve të Shqipërisë gjatë ushtrimit të profesionit të udhërrëfyesit, në funksion të zhvillimit të turizmit.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Harta të destinacioneve turistike.
 - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

5. Moduli: Interpretimi i historisë, trashëgimisë, kulturës, etnografisë dhe arkeologjisë.**PËRSHKRUESI I MODULIT**

Titulli dhe kodi	INTERPRETIMI I HISTORISË, TRASHËGIMISË, KULTURËS, ETNOGRAFISË DHE ARKEOLOGJISË	MK-13-321-22
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis kursantët me njohuri dhe shprehje për të interpretuar arkeologjinë, historinë e periudhave të ndryshme, si dhe antikitetin e Shqipërisë gjatë ushtrimit të profesionit të udhërrëfyesit, në funksion të zhvillimit të turizmit.	
Kohëzgjatja e modulit	150 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori, 80% Praktikë, 10% Vlerësime.	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm, të jenë mbi 18 vjeç dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në udhërrëfimin turistik”.	
Rezultatet e të Nxënës (RN), dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Kursantja/i shpjegon parahistorinë, qytetërimin ilir dhe Shqipërinë mesjetare. Kriteret e vlerësimit: Kursantja/i duhet të jetë e/i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të shpjegojë konceptin parahistori, histori, paleolit, neolit, eneolit, hekuri, pellazg;- të evidentojë karakteristikat thelbësore të qytetërimit neolitik dhe eneolitik;- të analizojë dukuritë e zhvillimit dhe të evolucionit të çdo etape historike;- të listojë disa nga emrat më të shquar të qytetërimit ilir dhe epirot;- të përcaktojë në hartë kufijtë e mbretërive ilire, dardane e shtetit të epirit.- të shpjegojë termat ilirë, epir, dardani, koloni helene, koinon;- të krahasojë kushtet e zhvillimit në mbretëritë ilire;- të analizojë jetën ekonomike dhe shoqërore në qytetet ilire epirote;- të agumentojë ndryshimet në iliri pas pushtimit romak. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">- Pyetje - përgjigje me gojë.- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Kursantja/i shpjegon informacionin për periudhat kohore të historisë së Shqipërisë.

Kriteret e vlerësimit:

Kursantja/i duhet të jetë e/i aftë:

- të japë një vështrim të përgjithshëm mbi burimet kryesore të shkruara në shkrimin e historisë shqiptare;
- të përshkruajë etapat kryesore të historisë së antikitetit vendon tonë;
- të shpjegojë shoqërinë, kulturën, arsimin, besimin tek ilirët, sipas autorëve antik;
- të shpjegojë ndikimin e qytetërimit greko-romak në kulturën ilire;
- të shpjegojë ndikimin e perandorisë romake në hapësirat ilire në Mesjetën e hershme;
- të përshkruajë vazhdimësinë ilire-arbërore dhe principatat kryesore arbërore;
- të shpjegojë rolin e krishtëritimit në jetën shoqërore të arbërve, si dhe lidhjen me civilizimin bizantin;
- të përshkruajë ndryshimet e territorit shqiptar nën sundimin e perandorisë osmane;
- të shpjegojë rezistencën shqiptare, nëpërmjet figurës së Gjergj Kastriot Skënderbeu;
- të përshkruajë periudhën e Rilindjes nëpërmjet figurave të shquara;
- të përshkruajë periudhën bashkëkohore të Shqipërisë, duke filluar nga njohja e pavarësisë së Shqipërisë deri në ditët e sotme;
- të shpjegojë rëndësinë e emetimit të monedhave të para prej argjendi në zhvillimin e marrëdhënieve tregtare me vendet përtej Adriatikut.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Kursantja/i përshkruan trashëgiminë e destinacionit turistik.

Kriteret e vlerësimit:

Kursantja/i duhet të jetë e/i aftë :

- të japë një vështrim të përgjithshëm mbi vendbanimet parailiriane si dhe dëshmitë e tjera arkeologjike të kësaj periudhe;
- të përshkruajë vendbanimet e periudhës protoiliriane, karakteristikat e tyre si dhe të objekteve arkeologjike përkatëse;
- të rendisë qytetet ilire që i përkasin shekullit V p.e.s. si dhe karakteristikat e tyre;
- të dëshmojë njohje shumë të mirë të qyteteve të tilla si: Amantia, Butrinti, Apollonia, Dyrrhachion;
- të shpjegojë në kontekstin historik zhvillimin e qyteteve ilire të shekullit të V-të;

- të krahasojë qytetet ilire me ato greke të së njëjtës periudhë;
- të shpjegojë karakteristikat, arkitekturën dhe objektet e qytetit të Amantias;
- të shpjegojë karakteristikat, arkitekturën dhe objektet e qytetit të Butrintit;
- të shpjegojë karakteristikat, arkitekturën dhe objektet e qytetit të Apolonisë;
- të shpjegojë karakteristikat, arkitekturën dhe objektet e qytetit të Dyrrhachion;
- të shpjegojë karakteristikat e qyteteve të ndërtuara në shekullin e IV-t;
- të shpjegojë karakteristikat, arkitekturën dhe objektet e qytetit të Bylis-it;
- të shpjegojë në kontekstin e ngjarjeve dhe zhvillimeve historike e shoqërore rikonstruktimin e qyteteve si Butrinti, Shkodra, Amantia;
- të njohë qytetet e Antipatresë dhe Damastion;
- të argumentojë ndikimin e zgjerimit të tregtisë në zhvillimin e qyteteve ilire,
- të shpjegojë rëndësinë e emetimit të monedhave të para prej argjendi në zhvillimin e marrëdhënieve tregtare me vendet përtej Adriatikut.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Kursantja/i përshkruan trashëgiminë kulturore materiale dhe shpirtërore në destinacionin turistik.

Kriteret e vlerësimit:

Kursantja/i duhet të jetë e/i aftë :

- të japë një vështrim të përgjithshëm mbi trashëgiminë kulturore, materiale dhe shpirtërore në Shqipëri;
- të shpjegojë përbërësit e trashëgimisë materiale në vendin tonë;
- të listojë monumentet e kulturës në vendin tonë;
- të përshkruajë vlerat dhe veçoritë e monumenteve të kulturës;
- të përshkruajë monumentet e kulturës së kultit në vendin tonë;
- të përshkruajë monumentet e kulturës në ndërtimet popullore si psh.: Gjirokastra dhe Berati;
- të analizojë vlerat e etnografike si trashëgimi kulturore psh.: kostumet popullore të zonave të ndryshme;
- të listojë muzetë kryesorë në Shqipëri;
- të shpjegojë veprat e trashëgimisë shpirtërore në Shqipëri;
- të shpjegojë veçoritë e folklorit muzikor, vokal, instrumental dhe koreografik në Shqipëri;
- të përshkruajë Iso-polifoninë popullore shqiptare dhe muzikën popullore homofonike të Shqipërisë së Veriut;
- të shpjegojë lidhjen ndërmjet turizmit kulturor me

gastronominë dhe artizanatin;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Kursantja/i interpreton sitet më të rëndësishme arkeologjike në vendin tonë.

Kriteret e vlerësimit:

Kursantja/i duhet të jetë e/i aftë :

- të japë një vështrim të përgjithshëm mbi vlerat e siteve arkeologjike në Shqipëri;
- të listojë sitet arkeologjike më të rëndësishme në vendin tonë;
- të shpjegojë veçoritë e kalave dhe kështjellave kryesore në vendin tonë;
- të interpretojë hartën arkeologjike të Shqipërisë;
- të rendisë sitet arkeologjike të epokës së hekurit;
- të përshkruajë karakteristikat e siteve arkeologjike të epokës së hekurit, veçoritë dhe ngjashmëritë e tyre me ato të rajonit si dhe përshkruajë objektet arkeologjike të zbuluara në to;
- të interpretojë veçoritë dhe karakteristikat e Parqeve Arkeologjike;
- të interpretojë se si ndërthurja e arkeologjisë me ambjentin natyror ka krijuar vlera kulturore dhe turistike;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 6 Kursantja/i shpjegon historinë e artit pamor në vendin tonë.

Kriteret e vlerësimit:

Kursantja/i duhet të jetë e/i aftë :

- të përshkruajë karakteristikat e artit në shqipëri dhe ndikimin e tij nga kultura të tjera;
- të listojë karakteristikat e kulturës ilire;
- të shpjegojë karakteristikat dhe veçoritë e siteve të butrinti, apolonisë, dyrrahut të interpretuara në kontekstin shoqëror dhe historik;
- të listojë mozaikët e lashtë të vizitueshëm ose jo në shqipëri;
- të shpjegojë karakteristikat e këtyre mozaikëve dhe veçoritë e tyre;
- të shpjegojë veprimtarinë e ikonografëve të shekullit xviii;
- të shpjegojë veçoritë e punës dhe ikonave të onufrtit;
- të shpjegojë artin në periudhen e pavarësisë, në vitet njëzetë të shek. XX dhe të artit bashkëkohor;
- të rendisë objektet më përfaqësues të artit në periudhen e pavarësisë, në vitet njëzetë të shek. XX dhe të artit bashkëkohor;

- të përshkruajë dhe shpjegojë artin në periudhen e pavarësisë, në vitet njëzetë të shek. XX dhe të artit bashkëkohor.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në hapësirë turistike.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në klasë mësimore dhe në terren. Atyre duhet ti jepen detyra të interpretojnë interpretuar arkeologjinë, historinë e periudhave të ndryshme si dhe antikitetin e Shqipërisë gjatë ushtrimit të profesionit të udhërrëfyesit, në funksion të zhvillimit të turizmit.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Harta të destinacioneve turistike.
 - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

6. Moduli: “Menaxhimi i riskut dhe i sigurisë gjatë udhëtimit turistik.”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	MENAXHIMI I RISKUT DHE I SIGURISË GJATË UDHËTIMIT TURISTIK	MK-13-322-22
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis kursantët me njohuri dhe shprehje për të menaxhuar rreziqet që mund të ndeshen gjatë udhëtimit dhe për të siguruar shëndetin e turistit në udhëtim.	
Kohëzgjatja e modulit	70 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori, 80% Praktikë, 10% Vlerësime.	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm, të jenë mbi 18 vjeç dhe të kenë kryer modulet “Hyryje në udhërrëfimin turistik” dhe “Aftësitë teknike dhe personale të udhërrëfyesit turistik”	
Rezultatet e të Nxënës (RN), dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursantja/i vlerëson dhe shmang rreziqet përpara realizimit të udhëtimit turistik. Kriteret e vlerësimit: Kursantja/i duhet të jetë e/i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të vlerësojë faktorët politikë të cilët mund të përbëjnë problem për sigurinë e turistëve (protesta, prishje të qetësisë etj.);- të vlerësojë rrezikshmërinë e zonave të caktuara;- të vlerësojë faktorët socialë të cilët mund ndikojnë në sigurinë e turistëve;- të vlerësojë faktorët klimaterikë dhe të terrenit të cilët mund ndikojnë në sigurinë e turistëve;- të kryejë ndërhyrjet e duhura në programin e zhvillimit të udhëtimit për të siguruar turistët;- të hartojë planin e lëvizjes së grupit në përputhje me kufizimet në zona të caktuara;- të informojë turistët për domosdoshmërinë e respektimit të normave sociale dhe marëdhënieve njerëzore në zona të caktuara në funksion të sigurisë së tyre;- të informojë dhe t’u argumentojë turistëve domosdoshmërinë e respektimit të kufizimeve në lëvizje në funksion të sigurisë së tyre;- të plotësojë dhe firmosë marëveshje me turistët lidhur me përgjegjësitë e tyre për sigurinë në udhëtimin që do të zhvillohet. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">- Pyetje - përgjigje me gojë.- Pyetje - përgjigje me shkrim.- Vëzhgim me listë kontrolli.	

RN 2 Kursantja/i vlerëson dhe shmang rreziqet gjatë realizimit të udhëtimit turistik.

Kriteret e vlerësimit:

Kursantja/i duhet të jetë e/i aftë:

- të interpretojë dhe respektojë klauzolat e kontratave të turistëve me agjencinë që lidhen me sigurinë;
- të sqarojë turistët lidhur me rreziqet e ndryshme që rrjedhin gjatë ushtrimit të veprimtarive të veçanta;
- të sqarojë turistët lidhur me rreziqet nga kushtet e motit dhe të terrenit gjatë udhëtimit turistik;
- t'i përmbahet, gjatë udhëtimit, marëveshjeve të firmosura lidhur me përgjegjësitë e turistëve për sigurinë;
- të respektojë protokollet e sigurisë dhe rregullat e sigurimit gjatë realizimit të udhëtimit me karakter të veçantë;
- të respektojë rregullat e sigurisë gjatë udhëtimit;
- të sigurojë përdorimin e pajisjeve dhe veshjeve të përshtatshme në vartësi të llojit të itinerarit;
- të sqarojë turistët gjatë udhëtimit, lidhur me vështirësitë teknike të realizimit të itinerarëve të veçantë, si dhe domethënien e tyre.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Kursantja/i jep asistencën e duhur në raste emergjente gjatë udhëtimit turistik.

Kriteret e vlerësimit:

Kursantja/i duhet të jetë e/i aftë:

- të informohet në vazhdimësi lidhur me shëndetin e turistëve gjatë udhëtimit turistik;
- të vlerësojë problemet paraekzistuese shëndetësore të turistëve dhe të kujdeset që realizimi i itinerarit të mos krijojë probleme për ta;
- të informohet në çdo destinacion mbi shërbimin shëndetësor dhe mundësitë për ndihmën e shpejtë;
- të njoftojë menjëherë ndihmë shëndetësore të kualifikuar, duke mos nënvleftësuar asnjë rast sado i parëndësishëm që mund të duket;
- të japë ndihmën e parë vetëm në raste që kërkojnë asistencë emergjente.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe terren.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete për të

menaxhuesit rreziqet që mund të ndeshen para udhëtimit, si dhe për të siguruar shëndetin e turistit në udhëtim.

- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënësit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Studime rasti.
 - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

7. Moduli: “Qëndrueshmëria në udhërrëfimin turistik.”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	QËNDRUESHMËRIA NË UDHËRRËFIMIN TURISTIK	MK-13-323-22
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i pajis kursantët me aftësi për të kryer veprimtari që synojnë të plotësojnë kërkesat e komuniteteve dhe ekosistemeve aktuale pa kompromentuar nevojat e gjeneratave të ardhme dhe që mbajnë parasysh praktika mjedisore dhe social ekonomike dhe ndikimet e tyre.	
Kohëzgjatja e modulit	40 orë mësimore Rekomandohet: 50% Teori, 40% Praktikë, 10% Vlerësime.	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm, të jenë mbi 18 vjeç dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në udhërrëfimin turistik”.	
Rezultatet e të Nxënës (RN), dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN 1 Kursantja/i respekton të drejtat njerëzore të pjesëmarrësve dhe aktorëve në një udhëtim turistik. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Kursantja/i duhet të jetë e/i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të argumentojë domosdoshmërinë e respektimit të të drejtave të gjithë komuniteteve, aktorëve, furnitorëve të shërbimeve me të cilët është në kontakt gjatë veprimtarive; - të tregojë respekt në kontakt me komunitetet, familjet, individët më të cilët kontakton gjatë veprimtarive; - të dokumentojë çdo akt, i cili cënon në çfarëdo forme të drejtat njerëzore në zonat ku ushtron veprimtari: shfrytëzimin e fëmijëve, punën e detyruar, trafikun njerëzor, punën e papaguar, etj., - të raportojë saktë aktet e mësipërme. <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Pyetje përgjigje me gojë. - Pyetje përgjigje me shkrim. - Vëzhgim me listë kontrolli <p>RN 2 Kursantja/i minimizon ndikimet e dëmshme në biodiversitet, ekosisteme dhe mjedisin natyror. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Kursantja/i duhet të jetë e/i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të sigurojë që veprimtaria e tij minimizon dëmtimin e natyrës, biodiversitetit dhe ekosistemeve; - të përshkruajë veprimet që dihet të ndërmerren për të minimizuar dëmtimin e natyrës, biodiversitetit dhe ekosistemeve; - të shpjegojë 7 parimet e “Leave no Trace Center for Outdoor Ethics”; 	

- të informohet lidhur me treguesit lokalë të ndryshimeve klimatike dhe ndikimin e tyre në ekosistemet, komunitetet dhe në shtimin e rreziqeve për ushtrimin e aktiviteteve për shkak të tyre;
- të hartojë rekomandime për partnerët lokalë dhe monitorojë praktikatat e tyre;
- të shmangë përdorimin e materialeve që dëmtojnë mjedisin.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Pyetje përgjigje me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Kursantja/i kujdeset për mirëqenien e kafshëve dhe raporton abuzimet me to.

Kriteret e vlerësimit:

Kursantja/i duhet të jetë e/i aftë :

- të shpjegojë rolin e turizmit në mirëqenien e kafshëve;
- të përshkruajë kriteret e përdorura nga Global Sustainable Tourism Council (GSTC) (Këshilli Global i Turizmit të Qëndrueshëm) për mbrojtjen e kafshëve;
- të raportojë abuzime me kafshët dhe tregtimin e tyre;
- të sensibilizojë partnerët dhe furnitorët lokalë të shërbimeve për mbrojtjen e kafshëve dhe ndalimin e abuzimit me to.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Pyetje përgjigje me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli..

RN 4 Kursantja/i zbaton marrëveshjet lokale dhe ndërkombëtare mbi tregtinë ilegale.

Kriteret e vlerësimit:

Kursantja/i duhet të jetë e/i aftë:

- të përshkruajë marrëveshjet ndërkombëtare që pengojnë tregtimin e veprave origjinale të artizanatit, antikiteteve, gjetjeve arkeologjike, kafshëve, etj.;
- të zbatojë procedurat dhe organizmat e raportimit të tregtimit të paligjshëm të veprave origjinale të artizanatit, antikiteteve, gjetjeve arkeologjike;
- të udhëzojë pjesëmarrësit në aktivitete turistike për mos blerjen e produkteve që mund të kontribuojnë në përdorimin e paqëndrueshëm të burimeve të destinacionit, mos marrjen e materialeve nga sitet arkeologjike, etj..

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Pyetje përgjigje me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në terren.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në klasë mësimore dhe në terren. Atyre duhet t'i jepen detyra për të vlerësuar mundësitë dhe veprimet konkrete që duhet të kryejnë gjatë udhëtimit për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit, të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Kompiutera të lidhur në internet.
 - Kriteret e qëndrueshmërisë të përdorura nga Global Sustainable Tourism Council (GSTC).
 - Botimet e “Leave no Trace Center for Outdoor Ethics“.
 - Përmbledhje e legjislacionit lidhur me turizmin dhe institucionet që ushtrojnë veprimtari në fushën e udhëtimeve dhe turizmit në vend.
-